

Premium Finance Invest

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETAVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 20

Premium Finance Invest

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2020

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	3,606,844	18,682,608
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	5	8,384,848	-
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	1,847,314	-
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	7	371,101	-
Hua afatshkurtra	8	-	60,885,000
Total aktive afatshkurtra		14,210,107	79,567,608
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	9	97,344,769	49,896,194
Aktive të mbajtura për Investim, me kontratë sipërmarrje	10	6,728,898,000	-
Aktive të mbajtura për investim	11	309,959,650	-
Parapagim për blerje aktive per investim	12	167,537,876	120,039,197
Total aktive afatgjata		7,303,740,295	169,935,391
Total aktive		7,317,950,402	249,502,999
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	13	1,969	143,500,972
Llogari të pagueshme tregtare	14	666,231	11,674,824
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	15	4,083,862	-
Detyrime tatimore	16	352,114	326,222
Të tjera detyrime	17	1,312,771	2,878,040
Total detyrime afatshkurtra		6,416,947	158,380,058
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	18	-	73,670,850
Llogari të pagueshme	19	92,775,000	-
Detyrime qe lidhen drejtperdrejt me aktive per investim	20	6,728,898,000	-
Total detyrime afatgjata		6,821,673,000	73,670,850
Totali i detyrimeve		6,828,089,947	232,050,908
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	21	500,000,000	20,000,000
Rezerva ligjore		5,935	-
Rezerva të tjera		(2,553,844)	(2,666,609)
Fitimi i ushtrimit		(7,591,636)	118,700
Total kapitali		489,860,455	17,452,091
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		7,317,950,402	249,502,999

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Premium Finance Invest
(Vlerat janë në Lek)
Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit neto	22	(861,369)	(1,028,856)
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(2,807,616)	(1,057,990)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
2) Të tjera shpenzime	23	(2,807,616)	(1,057,990)
Shpenzime të personelit	24	(669,900)	(864,305)
Paga dhe shpërblime		(574,029)	(750,636)
Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(95,871)	(113,669)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	9	(28,875)	-
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare neto	25	(3,223,876)	3,069,851
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(222)	(900)
2) Shpenzime të tjera financiare		(3,223,654)	3,070,751
Fitimi/humbja para tatimit		(7,591,636)	118,700
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	26	-	-
Fitimi/humbja e vitit		(7,591,636)	118,700
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(7,591,636)	118,700

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	20,000,000	-	(584,127)	(2,082,482)	17,333,391
Fitimi / Humbja e vitit				118,700	118,700
Lëvizjet përmes kapitalit			(2,082,482)	2,082,482	-
Pozicioni financiar i më 31 dhjetor 2019	20,000,000	-	(2,666,609)	118,700	17,452,091
Fitimi / Humbja e vitit				(7,591,636)	(7,591,636)
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	480,000,000				480,000,000
Lëvizjet përmes kapitalit		5,935	112,765	(118,700)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	500,000,000	5,935	(2,553,844)	(7,591,636)	489,860,455

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë:

ENKELT SALLA

Enkelt Salla
Administrator



Mazars shpk

Mazars shpk

Hartues | Pasqygrave Financiare

Emin Duraku Str., Biniakol Bunk.
No.5, 1013 Tirana, Albania
NIS: K321-20-01

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin operativ			
Fitim / Humbja e vitit		(7,591,636)	118,700
Shpenzimet financiare jomonetare		2,187,009	(322,395)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		28,875	-
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(2,218,415)	(60,885,000)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		(7,909,228)	11,684,769
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		(723,402)	791,876
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(16,226,797)	(48,612,050)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(47,477,450)	(75,527,891)
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		(264,683,329)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(312,160,779)	(75,527,891)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar		471,615,152	-
Hua të arkëtuar		61,044,570	140,777,001
Pagesa e huave		(220,384,555)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		312,275,167	140,777,001
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		(16,112,409)	16,637,060
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		18,682,608	3,653
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		1,036,645	2,041,895
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	3,606,844	18,682,608

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Premium Finance Invest është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar datë 14/04/2016 në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 500,000,000 Lekë, i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 500,000,000 Lekë.

Ortaku i shoqërisë është SIG Holding GmbH, zotëruese e 1 kuote ose 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është: “kryerja e çdo veprimtarie apo aktiviteti tregtar të ligjshëm në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Në mënyrë me specifike, Shoqëria do të mund të kryejë çdo aktivitet të ligjshëm tregtar import, eksporti, tregtia me shumicë e pakicë të mallrave, çdo aktivitet që lidhet me çfarëdolloj pasurie të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, duke përfshirë por pa u kufizuar vetëm në blerjen, shitjen, transferimin, ndërtimin, nën-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhënien me qira, leasing e pasurive të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, dhënien e fitimit e çdo të drejte apo privilegji në lidhje me këto pasuri.”. Aktiviteti i shoqërisë është me afat të pacaktuar.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Brigada VIII, Ndërtesa nr 6, Hyrja nr.7, Apartamenti 1, Tiranë. Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me NIPT L61711009G.

Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 4 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdher hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.6. Krahaseshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.15, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Euro/LEK	123.70	121.77
USD/ LEK	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale. Kuotat klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Aktive të mbajtura për Investim

Aktive afatgjata të mbajtura për investim, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga investimi mbi këto prona (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën individuale të pozicionit financiar në momentin që rreziket dhe përfitimet nga pronësia transferohen te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivitetet afatgjata të investuara maten me modelin e koston.

3.6. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.7. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata

materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 0%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë. Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet

Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Premium Finance Invest**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	3,586,844	18,682,608
Mjete monetare në arkë	20,000	-
	<u>3,606,844</u>	<u>18,682,608</u>

5. Llogaritë e arkëtueshme nga palet e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palet e lidhura detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Financim nga ortakut	8,384,848	-
	<u>8,384,848</u>	<u>-</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Të tjera llogari të arkëtueshme detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim Fitimi i parapaguar	5,450	-
Paradhënie punonjësve	680,348	-
TVSH e arkëtueshme	1,161,516	-
	<u>1,847,314</u>	<u>-</u>

7. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagime dhe shpenzime të shtyra detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagim për furnitor	371,101	-
	<u>371,101</u>	<u>-</u>

8. Hua afatshkurtra

Hua afatshkurtër detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Hua afatshkurtër	-	60,885,000
	<u>-</u>	<u>60,885,000</u>

Premium Finance Invest

Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive afatgjata materiale

	Aktive ne Proces	Paisje kompjuterike	Totali
Kosto			
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-
Shtesa	49,780,694	115,500	49,896,194
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	49,780,694	115,500	49,896,194
Shtesa	47,477,450	-	47,477,450
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	97,258,144	115,500	97,373,644
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 31 dhjetor 2018	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	-	-
Amortizimi i vitit	-	28,875	28,875
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	-	28,875	28,875
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	49,780,694	115,500	49,896,194
Gjendja më 31 Dhjetor 2020	97,258,144	86,625	97,344,769

10. Aktive të mbajtura për investim me kontratë sipërmarrje

Aktive për investim me kontratë sipërmarrje në 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Aktive të mbajtura për investim me kontratë sipërmarrje	6,728,898,000	-
	<u>6,728,898,000</u>	<u>-</u>

Shoqëria gjatë vitit 2020 ka lidhur dy kontrata sipërmarrje sipas të cilave shoqërisë I vihen në dispozicion 1,121,483 m2 sipërfaqe truall në zonën Darc, Durrës për të investuar. Në bazë të këtyre kontratave shoqërisë I lind e drejta për të kryer një investim në real estate në kombim të disa pronave të cilat do të zhvillohen mbi këtë truall. Kjo shumë përfaqëson vlerën ekuivalente të tokës ku do të zhvillohet investimi.

Bazua në kontratat e sipërmarrjes shoqëria ka njohur në pasiv të bilancit edhe detyrimet që rrjedhin nga këto kontrata (referencë nota 20).

11. Aktive të mbajtura për investim

Aktive të mbajtura për investim në 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Aktive të mbajtura për investim	309,959,650	-
	<u>309,959,650</u>	<u>-</u>

Shoqëria gjatë vitit 2020 ka blerë pasuri të paluajtëshme truall në zonën Drac, Durrës sipërfaqen prej 30,031 m2 të cilat do të përdoren për të zhvilluar investime në real estate.

12. Parapagim për blerje aktive për investim

Parapagim për blerje aktive për investim në 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Parapagim për blerje aktive për investim	167,537,876	120,039,197
	<u>167,537,876</u>	<u>120,039,197</u>

Shoqëria gjatë vitit 2019 dhe 2020 ka parapaguar për blerjen e pasurisë së paluajtëshme truall në zonën e Ksamilit Sarandë sipërfaqen prej 321,061 m2 të cilat do të përdoren për të zhvilluar investime në real estate.

Premium Finance Invest**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***13. Hua afatshkurtra**

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Overdraft	1,969	2,972
Financim nga WSI	-	113,055,500
Hua të tjera	-	30,442,500
	1,969	143,500,972

14. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Furnitorë vendas	666,231	2,121,796
Furnitorë të huaj	-	9,553,028
	666,231	11,674,824

15. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Të pagueshme tregtare ndaj WSI	3,087,940	-
Financim nga Infinity Investment	836,352	-
Financim nga Adria Entertainment	159,570	-
	4,083,862	-

16. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	140,191	112,181
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	211,923	214,041
	352,114	326,222

17. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Pagat e punonjësve	1,304,900	2,028,302
Të tjera detyrime	7,871	849,738
	<u>1,312,771</u>	<u>2,878,040</u>

18. Hua afatgjata

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Financim WSI	-	73,670,850
	<u>-</u>	<u>73,670,850</u>

19. Llogari të pagueshme

Llogari të pagueshme për blerje toke më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari të pagueshme për blerje toke	92,775,000	-
	<u>92,775,000</u>	<u>-</u>

20. Detyrime që lidhen drejtëpërdrejt me aktive për investim

Detyrime që lidhen drejtëpërdrejt me aktivet e dhëna për investim në bazë të kontratave të sipërmarrjes sipas të cilave shoqërisë I vihen në dispozicion 1,121,483 m² sipërfaqe truall në zonën Darc, Durrës në kembim të pronave që do të zhvillohen mbi këtë truall.

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime që lidhen drejtëpërdrejt me aktive për investim	6,728,898,000	-
	<u>6,728,898,000</u>	<u>-</u>

21. Kapitali

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 500,000,000 Lekë i zotëruar 100% nga Sig Holding GmbH. Gjatë vitit 2020 shoqëria ka zmadhuar kapitalin e saj nga 20,000,000 lekë në 500,000,000 Lekë. Shoqëria ka rezultuar me humbje (7,591,636) Lekë gjatë vitit 2020.

Më datë 28/10/2020 ka ndodhur ndryshimi i ortakut të vetëm të shoqërisë nga Power Invest në SIG Holding GmbH. Shoqëria Power Invest është bashkuar me përthithje nga shoqëria SIG Holding GmbH.

22. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit neto

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit neto më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(3,933,762)	(1,028,856)
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	3,072,393	-
	(861,369)	(1,028,856)

23. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Shpenzime të tjera	1,826,365	-
Shpenzime bankare	305,871	173,585
Shpenzime konsulenca ekonomike dhe juridike	186,557	757,080
Shpenzime qira zyra	148,752	-
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	111,500	-
Shpenzime qira makina	83,875	-
Abonime në revista online	63,526	-
Shpenzime higjene	29,167	-
Shpenzime kancelari	24,420	-
Taksa vendore	15,500	7,500
Materiale konsumi	12,083	5,000
Shpenzime për dhurata	-	114,825
	2,807,616	1,057,990

24. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për paga	574,029	750,636
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	95,871	113,669
	<u>669,900</u>	<u>864,305</u>

25. Shpenzime financiare neto

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 janë detajuar si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime interesi	(222)	(900)
Fitim nga këmbimet valutore financiare	-	3,077,704
Humbje nga këmbimet valutore financiare	(3,223,654)	(6,953)
	<u>(3,223,876)</u>	<u>3,069,851</u>

26. Tatimi mbi fitimin

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Fitimi para tatimit	(7,591,636)	118,700
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	<u>1,994,274</u>	<u>114,825</u>
Shpenzime për dhurata	-	114,825
Shpenzime për pritje dhe përcjellje	111,500	
Shpenzime për abonime në faqe online	63,526	
Shpenzime pa dokument të rregullt tatimor	1,819,248	
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	<u>(5,597,362)</u>	<u>233,525</u>
Humbje fiskale e mbartur		-
Fitimi Para Tatimit	<u>(5,597,362)</u>	<u>233,525</u>
Tatimi mbi fitimin	<u>-</u>	<u>-</u>
Fitimi i vitit	<u><u>(7,591,636)</u></u>	<u><u>118,700</u></u>

Premium Finance Invest**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020***(Vlerat janë në Lek)***Transaksione me palët e lidhura****Bilanci kontabël**

Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

31 dhjetor 2020**31 dhjetor 2019**

WSI

3,087,940

73,670,850

Infinity Investment

836,352

-

Adria Entertainment

159,570

-

4,083,862**73,670,850****Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve****31 dhjetor 2020****31 dhjetor 2019**

Blerje nga palët e lidhura

Sig Holding gmbh

52,233,557

-

WSI

1,334,941

-

Infinity investment sha

148,752

-

53,717,250**-****27. Angazhime dhe pasiguri***Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2020 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

28. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.